



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- A1 Mos respektim i hapave për procedimin e pagesave.
- A2 Mos raportim dhe shfrytëzimi i subvencionit jo në përputhje me qëllimin e dhënë.
- B1 Mos regjistrim i pasurive nën 1,000€ në programin e e-pasurisë.
- B2 Fatura nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditor, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 17 ditë deri në 60 ditë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetar i Komunes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Istogut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në veçanti, kemi identifikuar dobësi në fushën e llogarive të arkëtushme, obligimeve të papaguara, keqklasifikimi i shpenzimeve, menaxhimin e pasurive, menaxhimin e kontratave dhe subvencione. Këto çështje janë paraqitur si gjetje dhe rekomandime të mëposhtme për t'u shqyrtuar.

Rekomandimet e paraqitura më poshtë, synojnë të përmirësojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar, duke respektuar autoritetin që lidhet me menaxhimin e fondeve në sektorin publik. Plani ynë është të rishikojmë dhe të ndjekim këto rekomandime gjatë procesit të auditimit për vitin e ardhshëm. Raporti ynë ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Shuma e pagesave nga kategoria e pagave dhe medetjeve të realizuara nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për kontratën kolektive ishte 681,592€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 557,030€, ndërsa 124,562€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimi.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave

**Gjetja** Sipas Rregullës financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 22 Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet Urdhër blerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 29 mostrat të testuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, kemi vërejt se në 11 raste në vlerë 215,745€, urdhër blerja është proceduar pas datës se faturës dhe pranimit të mallit.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo efektive, për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna mos t'i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerrët urdhër blerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Mos raportim dhe shfrytëzimi i subvencionit jo në përputhje me qëllimin e dhënë

**Gjetja** Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve", e cila është në pronësi të komunës me 100% të aksioneve, ka bërë kërkesë më 14.10.2022 në komunë për ndarjen e fondeve buxhetore për qëllime të funksionalizimit të ndërmarrjes. Me vendim të kryetarit, komuna më datë 16.06.2023 ka ndarë mjete buxhetore në vlerë prej 50,000€. Pika 3 e vendimit përcakton se Ndërmarrja Publike është e obliguar të bëjë raportim për shpenzimin e fondeve financiare në mënyrë që të vërtetohet se ato janë shpenzuar sipas qëllimit për të cilin janë dhënë.

Ndërmarrja Publike nuk ka dorëzuar raport financiar në komunë. Po ashtu, bazuar në dëshmitë e marra (raporti i bankës-transaksionet), kemi identifikuar se Ndërmarrja ka tejkalluar shpenzimet për disa pozicione të caktuara.

- Në marrëveshje është përcaktuar që nga fondet e subvencionuara, ndërmarrja duhet të shpenzojë për paga një shumë prej 20,382€, ndërsa janë shpenzuar 33,445€, duke rezultuar në një tejkallim prej 13,063€.
- Për pagesën e tatimeve, siç janë tatimi i vlerës së shtuar, në pagë dhe kontributet pensionale, fondet e përcaktuara ishin në vlerë

13,447€, ndërsa janë shpenzuar 16,121€, duke rezultuar në një tejkalim prej 2,674€.

- Për licenca dhe sanimin e dëmeve, fondet e përcaktuar ishin në vlerë 6,150€, ndërsa janë vetëm shpenzuar 110€.
- Për shpenzimet operative duke përfshirë edhe komunalitë fondet e përcaktuara ishin në vlerë 6,950€, ndërsa janë nuk shpenzuar fare.
- Fondet e kërkuara për mbulimin e shpenzimeve të përmbaruesit privat ishin 1,060€, ndërsa u shpenzuan 944€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve në fushën e monitorimit të subvencioneve.

**Ndikimi** Shfrytëzimi i subvencioneve nga përfituesit jo në përputhje me qëllimin e dhënë, rezulton me vlerë të dobët të parasë së shpenzuar.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që mjetet fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e mjeteve fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e mjeteve fondeve nga përfituesit

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Mos regjistrim i pasurive nën 1,000€ në programin e e-pasurisë**

**Gjetja** Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Nga testimi i mostrave kemi vërejtur se pasuria jo kapitale në vlerë 81,440€, e blerë gjatë vitit 2023 nuk ishte regjistruar e tëra në sistemin "e-pasua". Pasuritë e blera dhe të paregjistruara kanë të bëjnë me inventarë, kamera, mobilje, pajisje trafiku, drita dekorative etj. për sektorin e administratës dhe arsimin. Megjithëse këto pasuri nuk janë regjistruar në sistemin "e-pasuria", komuna i ka evidentuar ato gjatë procesit të inventarizimit dhe i ka prezantuar në PVF.

Kjo ka ndodhur si rezultat i një sistemi jo efektiv të kontrolleve dhe monitorimit të zyrtarëve që merren me menaxhimin e pasurive jo financiare.

**Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurisë jo kapitale sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, ndikon humbjen a po tjetërsimin e mundshëm të pasurisë.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë jo kapitale në regjistra kontabël përkatësisht në sistemin e-pasurisë.



**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Vonesa në pagesën e faturave të pranuar**

**Gjetja** Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, nenin 39.1, përcakton që "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Gjatë trajtimit të detyrimeve kemi vërejtur se pesë (5) fatura, në vlerë prej 13,601€ nuk ishin paguar brenda afatit 30 ditore, vonesat e pagesave për këto raste janë nga 17 ditë deri në 60 ditë

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur fonde të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore..

**Ndikimi** Vonesat në pagesën e faturave, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të fondeve buxhetore, si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur fondet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,468,975€, prej tyre ishin shpenzuar 4,030,006€ apo 90%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, parqeve nacionale, rregullimin e lumenjve etj.

#### Çështja A3 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

**Gjetja** Pika 61 e Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik parasheh që të Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësimi i performancës së kontraktuesve të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik.

Komuna menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve nuk e ka mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes e-prokurimit.

**Ndikimi** Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikojnë në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të marrë informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

### Çështja B3 - Keq klasifikim i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike” shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në bazë të pagesave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate, në vlerë prej 28,394€. Si në vijim:

- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë paguar 9,000€ për kategorinë e investimeve kapitale, 5,001€ për kategorinë e subvencioneve dhe transfere, dhe 5,117€ për kategorinë e pagave dhe shtesave
- Nga kategoria e investimeve kapitale janë bërë pagesa në vlerë prej 9,276€ që i takojnë kategorisë subvencione dhe transfere.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe realizimin e pagesave nga kategoritë adekuate.

#### Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve

#### Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.3 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2023 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 1,511,472€. Tatami në pronë 1,245,358€, Ngarkesat për afarizem dhe biznes në vlerë 174,831€ dhe të tjera në vlerë 91,284€

### Çështja B4 - Dobësi në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

**Gjetja** Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesën, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Pjesa më e madhe e LL/A-ve i takon tatimit në pronë në vlerë 1,245,358€ rreth 82%, taksa komunale në biznes në vlerë 174,831€ (borxhe të mbetura nga viti 2012) rreth 12%, shfrytëzimi i pronës publike në vlerë 41,019€ rreth 3% dhe borxhe të tjera rreth 3%. Llogaritë e arkëtueshme ende mbeten të larta, edhe pse kemi një zvogëlim të tyre për 20% në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, sidomos kemi zvogëlim të borxhit nga tatimi në pronë, zvogëlimin e borxhit nga tatimi në pronë është si rrjedhojë e faljes së borxhit që ka ndodhur në vitin 2023.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së të arkëtueshmeve.

**Ndikimi** Mos inkasimi i të arkëtueshmeve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikojë edhe në arritjen e objektivave të Komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte vetëm një Auditor (Drejtorin e njesisë). Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës. Në vitin 2023 asnjë auditim nuk ishte përfunduar.

### Çështja B5 - Mos kompletimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

- Gjetja** Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit public. Neni 5.1.1 përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. Po ashtu NJAB në planin vjetor të auditimit për vitin 2023 ka planifikuar katër (4) auditime.
- Njesia e Auditimit të Brendshëm përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njesisë së auditimit. Kjo Njësi nuk kishte realizuar asnjë auditim nga katër auditimet që kishte planifikuar për vitin 2023.
- Shkak i mos përmbushjes së planit të auditimit ishte se Udhëheqësi i NJAB-së me datë 28.05.2023 është pensionuar dhe auditori tjetër është transferuar në këtë pozitë me datë 11.10.2023. Pra Komuna nuk ka ndërmarrë veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përbërjes dhe funksionit të Njesisë së Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur.
- Ndikimi** Mos kompletimi i NjAB-së, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësojë menaxhmentit marrjen e veprimeve për parandalimin e gabimeve të mundshme në kohë sa më të hershme.
- Rekomandimi B5** Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë, dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja C1 - Komiteti i auditimit jo funksional

- Gjetja** Udhzimit Administrativ MF-NR. 01/ 2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, Neni 6 Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë. Kryesuesi i Komitetit të Auditimit nuk duhet të jetë në pozitën udhëheqëse, dy të tretat (2/3) e anëtarëve duhet të jenë të jashtëm, dhe pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik.
- Komiteti i Auditimit (KA) të Brendshëm nga marsi 2022 ishte pa kuorum (dy prej tyre ishin tërhequr nga komiteti i auditimit) deri në dhjetor të vitit 2022, kur u kompletua me përbërje të re, e cila ka vetëm dy anëtar.
- Po ashtu komiteti i auditimit nuk i ka mbajtur katër takime që janë obligative, por vetëm dy.
- Mos funksionimi efektiv i KA-së ka ndodhur si pasojë e largimit të kryetarit dhe anëtarit të KA-së pasi i ka skaduar mandati, dhe komuna nuk ka emëruar anëtarët e rinj me kohë.

- Ndikimi** Komiteti i Auditimit jo efektiv ka ndikim në dhënjen e sigurisë për efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të komunës, funksionimin e auditimit dhe pavarësinë e auditimit të brendshëm.
- Rekomandimi C1** Kryetari, duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit, në mënyrë që të rishikojë planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit për funksionimin e kontrolleve të brendshme.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>13,051,471</b>	<b>15,259,638</b>	<b>14,692,547</b>	<b>11,589,771</b>	<b>11,920,156</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	11,806,883	13,352,625	13,009,403	9,897,405	9,385,694
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	98,602	25,031
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	0	1,528,317
Të bartura nga viti i kaluar	0	558,870	521,746	616,338	0
Të hyrat vetanake	1,244,588	1,244,588	1,103,098	945,931	941,700
Donacionet vendore	0	91,128	45,876	31,495	39,414
Donacionet e jashtme	0	12,427	12,424	0	0

Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 2,208,167 €. Kjo rritje është rezultat i pranimit të buxhetit nga donacionet, të hyrave të bartura nga viti paraprake dhe vendimeve të qeverisë. Në vitin 2023 komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final, me një rritje prej 5% në krahasim me vitin 2022.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>13,051,471</b>	<b>15,259,638</b>	<b>14,692,547</b>	<b>11,589,771</b>	<b>11,920,156</b>
Pagat dhe mëditjet	6,565,231	8,110,973	8,088,978	6,638,555	6,160,659
Mallrat dhe shërbimet	1,924,337	1,966,063	1,896,275	1,829,768	1,227,191
Komunalitë	200,000	200,000	198,874	188,599	157,882
Subvencionet dhe transferet	370,000	513,627	478,413	347,736	321,811
Investimet Kapitale	3,991,903	4,468,975	4,030,006	2,585,113	4,052,614


Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,545,742€. Rritja ishte nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës për rritjen e pagave.

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 41,726€. Rritja ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 143,627€ nga kjo vlerë: 103,260€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022 dhe 40,367 rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 477,072.€. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetjake të pa shpenzuara 413,870€ dhe rritja prej 63,202€ nga donacionet.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2023 ishin 1,244,588€, përderisa ishin realizuar 1,339,018€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 228,989€, si dhe të hyra nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës në vlerë 26,335€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.



**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>1,244,588</b>	<b>1,244,588</b>	<b>1,339,018</b>	<b>1,079,823</b>	<b>1,072,090</b>
Të hyrat tatimore	561,415	561,415	589,605	422,826	474,062
Të hyrat jo tatimore	683,173	683,173	749,413	656,667	598,028
Të hyrat tjera	0	0		330	

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar me 6 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, 5 rekomandime nuk janë adresuar ende dhe 1 është adresuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmarr veprimet e nevojshme në forcimin e kontrolleve të brendshme për korigjimin e regjistrit të pasurive, dhe në veçanti duke i verifikuar dhe korigjuar vlerat e pasurive me statutin "Investime në vijim" dhe nëse jetëgjatësia e përdorimit të pasurive është ajo e përcaktuara me rregullore dhe që vlera e pasurive të prezantohet e saktë.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi buxhetor i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive adekuate duke përfshirë edhe për detyrimet kontigjente që janë në përfundim të procedurave kontestimore, që t'ju shmangen nevojës për ekzekutim të atyre pagesave nga kategoritë tjera ekonomike. Pastaj të njëjtat të regjistrohen në kategoritë ekonomike përkatëse në përputhje me planin kontabël të Thesarit dhe të prezantohen saktë në PFV.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se mbledhja e LI.A nga tatimi në pronë bëhet sipas kërkesave dhe mënyrave të përcaktuara ligjore. Ndërsa për LI.A nga taksa në biznes dhe të qirave, të shqyrtohen të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore dhe deri përmes mjeteve juridike me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit, në mënyrë që të rishikojë planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit për funksionimin e kontrolleve të brendshme.	Pjesërisht janë ndërmarr veprime.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitën e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë, dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Nuk janë ndërmarrë veprime te nevojshme	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit




Hysen Restelica, Anëtar i ekipit



Fetah Osmani, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

01 NR. 316/2024

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ilir Ferati

(Kryetar i Komunës)

Data: 05.Qershor.2024, Istog,



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.



## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.